



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Data ____ / ____ / 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Shpenzime për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi PCV Materiale Elektrike 31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

- Vlera totale e Fondit limit për 4 vjet do të jetë : **10.000.000 (dhjetë milion) Lekë pa TVSH.**
- Fondi limit për vitin **2022** do të jetë : **2.500.000**(dy milion e pesëqind mijë) **Lekë pa TVSH .**
- Fondi limit për vitin **2023, 2024** dhe **2025** do të jetë respektivisht me të njëjten vlerë: **2.500.000**(dy milion e pesëqind mijë) **Lekë pa TVSH** për çdo vit .
- Burimi i financimit : Nga buxheti i bashkisë .

Kohëzgjatja e kontratës : do të jetë 48 muaj ose (4 vjet) nga data e lidhjes së kontratës .

Marrin pjesë të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

Lloji i procedurës së prokurimit do të jetë: **Procedurë e Hapur Mallra - Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara .**

Në bazë të nenit 2, 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, nenit 78, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit ushtrimorë duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të ketë një vlerë jo më të ulët se 30% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar nënenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogariturtë kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) **40 % të vlerës së përlllogariturtë kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënljore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në

zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Vërtetim i shlyerjes së gjithë detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për të gjithë kontratat të energjisë që disponon operatori ekonomik në Shqipëri.

2.2.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe vitin 2022 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e kriterit 2.2.2 dhe 2.2.3, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2021si dhe për vitin 2022 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006” Për sistemin e taksave vendore”, i cili detyron operatorët ekonomik ofertues që të dorëzojnë minimalisht vërtetimin për pagesën e dy kësteve (konkretisht deri në këstin e tretë i cili paguhet jo më vonë se data 20 tetor).

2.2.4. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve dhe xhiros mesatare është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii)*

shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- Furnizime të së njëjtës natyrë të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej jo më pak se 15% e fondit limit të vënë në dispozicion .

Këto furnizime të së njëjtës natyrë do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën ,për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 15% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve e të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, certifikata cilësisë duhet në përputhje me objektin e prokurimit dhe konkretisht :

- ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”; *ose ekuivalent*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, këto mallra duhet të jenë me cilësi sipas certifikatës iso të mësipërme .

2.3.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të ketë në listëpagesë të paktën muajin e fundit :

- 1 (një) shofer ose 1 (një) manovrator , për të cilin duhet të paraqesë:

-kontratë pune të lidhur përpara noterit

-librezë pune

Në rastet kur mjete sipas pikës 2.3.4 të DST është marrë me qera, nuk është kusht që shoferi/manovratori të jetë në listëpagesën e shoqërisë. Ai do të lejohet të plotësohet edhe **nëpërmjet nënkontraktimit** për këtë kontratë.

2.3.4 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Mjetet	Sasia	Gjendja
Një kamion ose kamionçinë	1 copë	Pronësi ose me qera

Për përmbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme nëse është rasti), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme nëse është rasti), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- c) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- d) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që mjete më sipër do të jetë i angazhuar vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetin që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Mjeti i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së furnizimit sipas kërkesave me mallrat e kërkuara në preventivin e hartuar nga Agjencia e Shërbimit Komunal, Bashkia Kuçovë. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues duhet të disponoi një nga mjetet e kërkuara për sa më sipër, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë sasinë e mallrave ,mënyrën e furnizimit , vlerën e kontratës, është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se do ta realizojn me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

2.3.5 Operatori ekonomik për mallrat e furnizuara objekt prokurimi duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e mallit e cila të jo më pak se 1 vit nga marrja e tyre në dorëzim.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e autoritetit kontraktor në objektin e tij.

2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin nga një mostër të mallrave si mëposht :

➤ **Kërkohen të paraqiten mostra për keta artikuj.**

1)Ndricules rrugor Led 150W

2)Ndricules rrugor Led 100W

3)Ndricules rrugor Led 50 W

4)Automat mag/termik 1P63A

5)Automat mag/termik 1P10A

- 6) Lëshues 3P+N, 63A
- 7) Driver për ndriçues LED
- 8) Pllaka PCB për ndriçues LED
- 9) Kabëll elektrik 4 x 6 (1 metër mostër)
- 10) Kabëll elektrik 4 x 4 (1 metër mostër)
- 11) Kabëll elektrik 3 x 2.5 (1 metër mostër)

- Mostrate mallrave janë kërkuar për t'i krahasuar ato me specififikimet teknike .

- Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit deri në orën ____:00.

Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikimi.

2.3.8 Për ndriçuesit rrugor dhe automatet termik duhet paraqitur autorizim prodhuesi/distributori shoqeruar me kataloget perkates, si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Në lidhje me kërkesat **2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8** , në bazë të nenit **Neni 40 për Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave** , pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime , ku thuhet se në pikën 6 neni 40 se Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose.

- **Në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b të LPP** ku shprehimisht thuhet ;

“Në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë”.

*Gjithashtu dhe në bazë të nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”*.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT